



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada-Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3 (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, neni 30 paragrafi 30.3 Ligji Nr.02/L-8 për Verëra, 14 tetor 2005,

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,  
Miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 16/2009**  
**Për caktimin e kriterëve për vënien e shënimeve në etiketë**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kriteret për vënien e shënimeve në etiketë, për vitin e vjeljes, varietetet e hardhive, medaljet e fituara dhe emrat tradicional.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura, kanë këtë kuptim:

“**Etiketim**” nënkupton të gjitha përshkrimet dhe referencat tjera të emrit, markës tregtare, simboleve, ilustrimeve apo shenjave tjera të cilat janë të vendosura në çdo paketim, dokument, shënim, shirit që referohet një produkti të dhënë.

“**Prezantimi**” nënkupton çdo informacion i përcjell për konsumator, duke u mbështetur në paketimin e produktit në fjalë, që përfshinë edhe formën dhe llojin e shishes.

**Neni 3**

1. Etiketimi dhe prezantimi i produkteve të verës që i referohet nenit 22 dhe 30 të Ligjit Nr. 02/L-08 për Verërat, përmbanë këto karakteristika të veçanta:

- 1.1 Viti i vjeljes;
- 1.2 Përbërja e verës;
- 1.3 Lloji i rrushit;
- 1.4 Prejardhja gjeografike;
- 1.5 Indikacionet gjeografike;
- 1.6 Përmbajtja alkoolike;
- 1.7 Emri tregtar;
- 1.8 Shkalla e cilësisë;

- 1.9 Vëllimi;
- 1.10 Tipi i verës;
- 1.11 Të dhënat për mbushësin;
- 1.12 Numrin Zyrtar të Kontrollit –NZK;
- 1.13 Serinë e mbushjes dhe
- 1.14 Kategorizimi i vjeljes.

#### **Neni 4**

##### **Numri zyrtar i kontrollit**

Numri Zyrtar i Kontrollit – NZK, duhet të vendoset në çdo etiketë të verës cilësore dhe kulminante që ka kaluar vlerësimin organoleptikë, ndërsa për verërat e tryezës nuk është obligues.

#### **Neni 5**

##### **Kategorizimi i vjeljes**

1. Në çdo etiketë të verës së mbushur, duhet të paraqitet kategoria e vjeljes, si vijon:
  - 1.1 Vjelje e rregullt;
  - 1.2 Vjelje e zgjedhur;
  - 1.3 Vjelje e vonë;
  - 1.4 Vjelje e zgjedhur e kokrrave të thara dhe
  - 1.5 Verë e ngrirë.

#### **Neni 6**

##### **Medaljet dhe çmimet e fituara**

1. Kompanitë prodhuese të verës të cilat marrin pjesë në Panaire dhe Ekspozita Internacionale të verës dhe fitojnë medalje apo ndonjë çmim tjetër, janë të obliguara që atë tip të verës ta shënojnë në përputhje me çmimin e fituar.
2. Kompanitë përfituese nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguara që në Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të sjellin dokumentin shoqërues për fitimin e çmimit.

#### **Neni 7**

##### **Verërat shkumbore**

1. Verërat natyrore shkumbore të gazuara sipas përmbajtjes së sheqerit të reduktuar në etiketën e tyre, përmbajnë këtë përshkrim:
  - 1.1 shumë e thatë;
  - 1.2 e thatë;
  - 1.3 gjysmë e thatë;
  - 1.4 e ëmbël.

#### **Neni 8**

Të gjitha kompanitë prodhuese të verës dhe prodhimeve tjera nga rrushi dhe vera dhe kompanitë tregtuese të verës janë të obliguara që në Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të sjellin nga një mostër të etiketës së verës e cila mendohet të vendoset në qarkullim për import apo eksport.

### **Neni 9**

Kompanitë prodhuese, tregtuese të verës, eksportuese për çdo ndryshim në etiketën e prodhimeve të verës janë të obliguar që të bëjnë njoftim në Entin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

### **Neni 10**

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet sipas nenit 48 Ligji Nr.02/L-8 për verëra.

### **Neni 11**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, më 24.12.2009

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi

---